




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:



F T O J

Mbledhjen e pestë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **15.06.2021** (e martë) duke filluar në orën **11:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Diskutim rreth situates se ambientit në teritorin e Komunës;
3. Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim;
4. Të ndryshme;

Me: 08.06.2021
Në: Novobërdë

Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërt e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 17.05.2021, duke filluar në orën 11:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjovic, Aleksander Pavic, Zymer Zymeri, Lirim Gashi, Behare Jashari, shefja e ZKKK Jasmina Denic dhe perfaqësuesi i OSBE-së.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendeti të pranishmit e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raport rreth situates me Pandemi Covid 19 si dhe raportim rreth procesit të vaksionimit në Komunën tonë;
3. Raportim rreth punës dhe aktiviteteve të ZKKK;
4. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend dite?

Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i ditës nga antarët prezent të Komitetit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja e hapi diskutimin rreth kësaj pike.

Pasi nuk pati asnje vërejtje aprovohet njëzëri procesverbali i mbledhjes së kaluar nga antarët prezent të Komitetit për Komunitete.

Pika e dytë: Raport rreth situates me Pandemi Covid 19 si dhe raportim rreth procesit të vaksionimit në Komunën tonë;

Kryesuesja tha: nuk është askush që ta prezantoj këtë pikë as nuk ka njoftuar askush asgjë se pse nuk janë prezent, a pajtoheni që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme?

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: mos është keqkuptuar nga Drejtori i Shendetësisë pasi që në ftesë ka qenë e shkruar dita e martë.

Kryesuesja tha: i kemi njoftuar edhe me telefon dhe të gjithë janë njoftuar që sot është mbledhja. Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: të përseritet kjo pikë edhe në mbledhjen e ardhshme.

Pika e tretë: Raportim rreth punës dhe aktiviteteve të ZKKK;

Për këtë pikë ja dha fjalën shefes se ZKKK Jasmina Denic.

Jasmina Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket punës Komunale të ZKKK që e kam permendur edhe në raportin e kaluar po shpresoj se do ta kemi fatin që Ministri të na vizitoj pasi që ka filluar ti vizitoj disa Komuna në regjion. Një informat tjetër është se Kryetari i Komunës e ka caktuar një takim me Ministrin për të enjten në Ministri. E rendësishme për ne është që të vazhdohet projekti DRK5 dhe të vazhdohet puna me Bashkësin Evropiane që kemi

pasur për DRK6. Ajo që është e rëndësishme është se Ministri e ka nënshkruar një marrëveshje të data bazës elektronike që do të jetë për të gjitha Komunitetet si dhe për Komunitetin tonë ku kjo data bazë do ta vlerësojë procesin e kthimit. Ajo që është e rëndësishme për ne por ende nuk është përfunduar në Ministri është se bordi kryesor ende nuk ka pasur takim dhe ne i kemi 8 projekte që i kemi dorëzuar për realizim, na kanë informuar se ndoshta kjo mbledhje e këtij bordi do të bahet gjatë këtij muaji ose në muajin e ardhshëm. Në nivelin lokal jemi duke punuar me 4 familje të cilat i kemi të regjistruara për kthim dhe e kemi bërë vlerësimin në terren muajin e kaluar. Në bashkpunim me UNHACER-in kemi bërë vlerësimin e shtëpive të vjetëra, kemi pasur një takim online me këshillin danez për të kthyerit. Gjithashtu kemi percjell edhe gjendjen e vaksionimit në komunitet kundër covidit dhe i kemi njoftuar partizanet tanë si OSBE-n, UNHACER-in se komuniteti Serb dhe Rom shkojnë në Serbi që ta marrin vaksinën dhe e kanë transportin e organizuar ndërsa gjatë dy javëve të fundit sa janë i informuar ky transport nuk ekziston, pra transporti ka qenë vetëm në fillim të vaksinimit. Një informatë që kemi marrë prej ambullantes është se mundë të kryhet një test i shpejtë për të gjithë qytetarët e të gjitha komuniteteve. Për material ndërtimor kanë dorëzuar 4 familje kërkesa, andaj skishte qenë keq që ne të gjithë së bashku të organizohemi që tju ndihmojmë këtyre katër familjeve që të marrin material ndërtimorë por kjo iniciativë duhet të rrjedhë nga Komiteti i Komuniteteve, ndoshta edhe në formë të kërkesës por këto projekte të mos humben, komiteti duhet të bëjë një iniciativë që të lëshohet material këtyre shtëpive shqiptare, pasi që të kërkojë unë donator si përfaqësuese e zyrës duhet ta kem një dokument, pasi që ne nuk kemi bazë ligjore që ti ndihmojmë komunitetit shumicë, kjo është sa i përket punës së zyrës sonë nëse keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Lirim Gashi pasi përshëndeti të pranishmit tha: iniciativa juaj më pëlqej por më intereson të di që se kush janë ato familje shqiptare që kanë aplikuar?

Jasmina Denic tha: mundë të vish në zyrë ti shikosh, zyrja është e hapur për të gjithë.

Lirim Gashi tha: e mbeshtes këtë iniciativë.

Jasmina Denic tha: ju si komitet kur ta merrni iniciativën për më dergu këtë kërkesë kishte qenë mirë që të dergoni edhe një kërkesë tjetër p.sh. nëse keni ide me nismë ndonjë shkollë ose shtëpi të kultures, në mënyrë që ne ta kemi kërkesën tuaj dhe në momentin që na paraqitet ndonjë donator unë me pas bazë juridike, e dini që herën e kaluar ideja ka qenë e juaja që shtëpinë e kultures në Koretistë ta funizojmë me mjete të punës.

Kryesuesja i pyeti antarët e Komitetit se a pajtohen që të dergojnë kërkesë Jasmines për propozimin e mësipërm?

Aleksander Pavic pasi përshëndeti të pranishmit tha: nuk kishte qenë keq që Shpresa ta bëjë këtë kërkesë që tju ndihmohet çdo pjesëtar i komunitetit që ka nevojë.

Zymer Zymeri pasi përshëndeti të pranishmit tha: Jasmina po tregon qartë, ne duhet të kërkojmë atë që ka nevojë fshati ynë, ne duhet të bëjmë projekte për çka kemi nevojë, të bëjmë kërkesë dhe tja dergojmë Jasmines.

Jasmina Denic tha: nëse mundë tju jap një propozim kishte qenë mirë që ta kemi kërkesën deri deri për mbledhjen e ardhshme, ta kemi kërkesën e qartë si p.sh. kemi kërkuar material ndërtimor për kaç shtëpi ose të rregullohet në një fshat diçka si p.sh. një rrugë, trotuar ose qeshme etj., më mjafton që ju ta keni kërkesën ta merrni vendimin dhe në bazë atë vendimi të kërkesës tuaj unë mundë të veprojmë.

Dobrivoje Djordjevic tha: iniciativa është e mirë, por mos të ndodhë që kërkesa jonë të keqkuptohet, ne nuk kemi qasje se kush çka ka fituar do të kishte qenë mirë nga ana juaj që mos të ndodhë që një familje të përfitojë disa herë, të jetë lusht që dikush që ka përfituar të mos marrë 3 vite.

Jasmina Denic tha: ata që kanë përfituar nga ZKKK nuk kanë marrë për herë të dytë, ne kerkojm donator dhe donatorët financiojnë familjet që presin ndihmë.

Zymer Zymeri tha: duhet ditur se si shkojnë punët, nuk vendos Jasmina se kush përfiton por vendosin donatorët.

Pika e katërt: Të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Lirim Gashi tha: e kam një pyetje për Kryesuesen pasi që në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që të ndahen nga 100€ për nënat e reja ndërsa kjo pikë nuk ka shkuar në Kuvend më intereson ta di arsyen se pse nuk ka shkuar në Kuvend?.

Shpresa Kqiku tha: për arsye të transportit nuk kam pasur mundësi që të vij ta propozoj, këtë muaj do ta propozoj.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:50.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete

